

Për: Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE

Nga: Balkan Green Foundation – BGF

Datë: 31 Janar 2022

KOMENTE

për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të Tarifave (2021-2022)

Pas analizimit të të dhënave për kategorizimin e konsumatorëve të dërguara nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energjinë lehtë konkludohet që trendi i rritjes së shpenzimit për ngrohje është në rritje dhe si i tillë do të rrezikoj qëndrueshmërinë e vet sistemit elektro-energjetik. Andaj vurja në fuqi e mekanizmit të tillë nxitës sikurse bllok-tarifa është masë e duhur për ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve ndaj energjisë, porse pragu prej 600 kWh duhet të rritet.

BGF përshëndet vendimin që mos të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike për bizneset të cilat veçse janë duke paguar më shtrenjtë për energjinë elektrike dhe çdo rritje e çmimit për këtë kategori do të mund të ndikonte në rritje të inflacionit dhe çmimeve në treg.

Duke pasur parasysh gjendjen, propozimet tona si organizatë rajonale që mirret me fushën e energjisë janë:

- Rekomandojmë që të ketë rritje lineare të çmimit të energjisë elektrike për të gjitha kategoritë pas shqyrtimit të jashtëzakonshëm tarifor dhe jo rritje e ndjeshme eksponenciale për një apo disa kategori të caktuara.
- Rekomandojmë që të vendoset kategorizim i veçantë dhe strukturë tarifore për sezonën e verës dhe strukturë tjetër tarifore për atë të dimrit.
- Rekomandojmë që kategoria nga 600 kWh të kalojë në 800 kWh në sezonën dimërore, dhe kjo sezonë të subvencionon tarifën dimërore nëpërmjet tarifave verore.

Sidoqoftë, nuk mund të anashkalojmë pa e përmendur drojën se ndryshimi i përnjëhershëm i strukturës tarifore, pa politika përcjellëse për rritjen e masave të efikasitetit të energjisë në vend do të paraqes problem të madh për shpenzuesit e energjisë përmbi 600 kWh të cilët për momentin nuk kanë alternativë tjetër ngrohjeje, përveq energjisë elektrike.

Shqetësuese mbetet poashtu mundësia që kalimi nga shfrytëzimi i energjisë elektrike në ngrohje me lëndë djegëse të ngurta, sikurse janë druri dhe thëngjilli, do ta dëmtojë edhe më tepër cilësinë e ajrit në vend dhe mund të ndikoj në shpyllëzim dhe degradim të mjedisit.

Andaj, BGF apelon që ndryshimet e propozuara të marrin për bazë përveq aspekteve sociale dhe ekonomike, gjithashtu edhe koston mjedisore të propozimit.

Sinqerisht,

Balkan Green Foundation